

Skuadrat tona

Në çdo strukturë, fëmijët priten nga një skuadër edukative profesionale.

Ajo përbëhet nga njerëz që vijnë nga APEMS-ë të ndryshme dhe krijohet posaçërisht për kohën e pushimeve.

Skuadra edukative mbështet dhe inkurajon...

- PJESËMARRJEN E FËMIJËVE

Fëmijët shprehin idetë tyre dhe krijojnë aktivitetet e tyre, me mbështetjen e të rriturve.

- TË DREJTËN PËR TË QENË I NDRYSHËM

Të rriturit i shoqërojnë fëmijët në pranimin e të qenit të ndryshëm, me qëllim që secila dhe secili të gjejë vendin e vërtetë në grup.

- KËNAQËSINË PËR TË QENË BASHKË

Fëmijët zënë miq dhe mike, mësojnë të njohin njëri tjetrin dhe të ndajnë interesat dhe dëshirat e tyre.

- BESIMIN

Të rriturit kanë besim në aftësitë e fëmijëve, gjë që u lejon të krijojnë lidhje të forta dhe të përjetojnë përvoja në një mjedis të qetë.

Për më tepër informacione lidhur me oferta të tjera për Pushimet e Qytetit të Lozanës.

Shërbimi i shkollave dhe ai jashtëshkollor

Drejtorja e fëmijërisë, rinisë dhe lagjeve
Place Chauderon 9 – 1003 Lausanne
021 315 64 11

→ **DOMAINE ACCUEIL
VACANCES**



www.lausanne.ch/apems



Ville de Lausanne

Shërbimi i shkollave
dhe ai jashtëshkollor

Pritja gjatë pushimeve 1-6P (APEMS+VAC)



Shkurt...

→ APEMS+VAC-ja pret fëmijët nga 1P në 6P gjatë javëve të pushimeve shkollore dhe plotëson kështu ofertën e Pushimeve të propozuara nga Qyteti i Lozanës.

Një kohë për të...

→ gjetur njëri tjetrin, luajtur, mësuar gjëra të reja, marrë pjesë, përfituar nga koha e lirë dhe për të krijuar lidhje.

Ku është ?

Në disa APEMS në Lozanë.

Kush mund të përfitojë ?

vendet parashikohen së pari për fëmijët prindërit e të cilëve punojnë, ndjekin një formim ose janë në kërkim të një pune (të regjistruar në ORP).
Përparësi u jepet fëmijëve më të vegjël.

KUR SHKOHET ATJE ?

..... PARADITE

07.00 - 14.00

..... PASDITEI

12.00 - 18.30

..... DITA

07.00 - 18.30

Mbyllur gjatë tri javëve në verë dhe nga Krishtlindjet deri në Vitin e Ri



Çfarë bëjnë fëmijët atje ?

Zbulojnë gjëra të reja !



Gjatë pushimeve, bota zmadhohet : fëmijët dalin, eksplorojnë mjedise të pazakonshme, vizitojnë vende kulturore, vëzhgojnë dhe ecin në këmbë, me autobus, me tren apo... me anije.

Çlodhen !



Në mungesë të orarit shkollor, ritmi ngadalësohet : fëmijët mund të ëndërrojnë, soditin, të mos bëjnë asgjë dhe të kënaqen duke u çlodhur.

Krijojnë lidhje !



Duke u njohur gjatë pushimeve, krijohen lidhje : takimet; lojërat, projektet dhe ritualet favorizojnë krijimin e miqësive.

Luajnë !



Të qenit bashkë mundëson lojra të shumta : fëmijët mund të marrin pjesë në veprimtari sportive, argëtuese, artistike të organizuara nga skuadra edukative ose të imagjinojnë veprimtari të vetat.